

QLT

Aktivitetet e Qendrës së Laboratorëve Testuese (QLT)

Laboraret e Departamentit janë të akredituara me standardin ndërkombëtarë SK EN ISO/IEC 17025 që nga viti 2010 për ekzaminimin e përshtatshmërisë shëndetësore të cilësisë dhe sigurisë së ujit dhe ushqimit.

Ekzaminimi i përshtatshmërisë shëndetësore të cilësisë dhe sigurisë së ujit: ofron shërbime të marrjes dhe analizës së të gjitha mostrave të ujit (ujit për pije nga ujësjellësi dhe bunaret, ujërat e ambalazuara dhe ujërat rekreative) duke përfshirë punën në terren dhe punën laboratorike.

Ekzaminimi i përshtatshmërisë shëndetësore të cilësisë dhe sigurisë së ushqimit realizohet nga specialist të profileve të ndryshme, mjekë, kimist, biolog molekular të cilët realizojnë analizat e parametrave specifik të përcaktuara me rregullore. Në kuadër të këtij organizimi ekspertët dhe laboraret bëjnë analizat mikrobiologjike, metaleve, aditiveve, mykotoksinave, antibiotikeve, hormoneve, origjinës së mishit, pesticideve, GMO (ushqimet gjenetikisht të modifikuara), vlerat energjetike të ushqimit dhe treguesit e kualitetit të ushqimit.

Në kuadër të implementimit të kërkesave të standardit dhe procedurave të ISO/IEC 17025, Qendra e Laboratoreve Testuese (QLT) në IKSHPK merr pjesë në Programet e krahasimeve ndërlaboratorike për verifikimin e cilësisë së kompetencës profesionale (PT).

Programi i parë LAMP (Lead and Multielement Proficiency) – Center for Disease Control and Prevention (CDC)

Programi i dytë Proficiency Interlaboratory Study on Pasteurised Homogenized Milk – Univerza v Ljubljani

Programi i tretë EQUIP (Ensuring the Quality of Urinary

Iodine Procedures) – Center for Disease Control and Prevention (CDC)

Programi i katërt QUICK (Quality Urine Iodine Control) – Kazakh Academy of Nutrition.